



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 212/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, rr. “Qamil Hoxha”, kundër debitorit N.P.N “D...”, me NRB, me pronar D.G, me seli Komuna e Malishevës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.29/19 të datës 17.01.2019 të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 02.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit N.P.N “D...”, me seli Komuna e Malishevës, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 29/19, të datës 17.01.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj.

II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.29/19, i datës 17.01.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj.

A r s y e t i m

Kreditori, Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit N.P.N “D...”, me seli Komuna e Malishevës, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartues – Vendimi 01.Nr.40-112/2018/A të datës 06.10.2018, i formës së prerë prej datës 05.12.2018 dhe i ekzekutueshëm prej datës 05.12.2018, me të cilën debitori është obliguar që kreditorit në emër të masës ndëshkimore t’ia paguaj shumën prej 3,000.00€ (tre mijë euro) në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimi të vendimit në xhirollogarinë Nr. B..., sipas numrit të Vendimit.

Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale –

Inspektorati i Punës, me datë 17.01.2019, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.29/19, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, Vendimit të Inspektoratit të Punës 01.Nr.40-112/2018/A, të datës 06.10.2018 me të cilën është detyruar debitori që në afat prej 7 (shtatë) ditësh, t'ia paguaj kreditorit në emër të masës ndëshkimore shumë prej 3,000.00 € (tre mijë euro), nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe mjeteve të luajtshme në pronësi të tij, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas Udhëzimit Administrativ MD.NR.06/2014.

Debitori N.P.N "D...", brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, duke theksuar se propozimi për përmbarim në këtë çështje është paraqitur në mënyrë jo të pranueshme pasi që personi i njëjtë – inspektori i punës N.F, paraprakisht i ka lëshuar dy raporte zyrtare për këtë çështje dhe pastaj ka lëshuar edhe Vendimin e shkallës së parë 01.Nr.40-112/2018/A, të datës 06.10.2018, dhe se duke vepruar në këtë mënyrë është cenuar rënd parimi i objektivitetit dhe paanshmërisë sipas nenit 7 të LPA-së. Më tutje ka shtuar se propozimi për përmbarim nuk është i plotë dhe është i mangët pasi vetëm është i nënshkruar nga ana e kreditorit. Më tutje ka shtuar se propozimi është në kundërshtim me normat e Ligjit për konfliktin e Interesit dhe si pasojë e shkeljes së parimit të nenit 7 të LPA-së, propozimi për përmbarim nuk mund të ketë vlerë ligjore dhe fuqi juridike. Po ashtu ka theksuar se lidhur me këtë çështje është iniciuar konflikt administrativ me datën 25.01.2019 me të cilën janë atakuar vendimet e Inspektoratit të Punës. Në fund i ka propozuar Gjykatës që të pranohet si i bazuar prapësimi i palës debitori dhe të anulohen të gjitha veprimet përmbarimore dhe të ndërpritet urdhri për përmbarim deri në vendosjen e padisë nga ana e Gjykatës.

Kreditori me përgjigjen në prapësim ka deklaruar se propozimi për përmbarim është paraqitur pasi që debitori nuk e ka përmbushur detyrimin për pagesën e gjobës së shqiptuar në mënyrë vullnetare, andaj kreditori është detyruar që të njëjtin ta kërkoj përmes procedurës së përmbarimit. Më tutje i ka kundërshtuar thëniet e debitorit se në këtë rast mungon baza juridike për përmbarim sepse procedura është zhvilluar në përputhje me dispozitat e LPP-së, si dhe Inspektorati i Punës i ka zbatuar dispozitat ligjore në mënyrë të drejtë dhe drejtë është vërtetuar gjendja faktike. Ka shtuar se mbetet pranë propozimit të dhënë duke kërkuar nga gjykata që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin mbështetur në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Vendimin 01.Nr.40-112/2018/A, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu Vendimi 01 Nr.40-54/2018/A, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”,* pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimin 01.Nr.40-112/2018/A, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbartueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase Vendimi 01.Nr.40-112/2018/A, i datës 06.10.2018, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 05.12.2018 dhe i ekzekutueshëm me datë 05.12.2018.

Gjykata po ashtu i vlerësoi edhe pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim se në rastin konkret është cenuar parimi i objektivitet dhe pa anshmërisë dhe gjeti se pretendimet e tilla nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore dhe nuk mund të vlerësohen në këtë

procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të së cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi. Ndërsa pretendimi i debitorit se është iniciuar konflikt administrativ lidhur me këtë çështje për gjykatën është i pa bazuar nga fakti se Vendimi 01.Nr.40-112/2018/A, i datës 06.10.2018 përbën dokument përmbarimor konform nenit 24 par.3 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se “ *Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.*”, e po ashtu bazuar në dispozitën e nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, me të cilën është përcaktuar se: “*Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe*”, rezulton se paraqitja e padisë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbarimore dhe si rrjedhojë nuk e ndalon përmbarimin.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenet 21, 22 par.1 pika 1.2, 24, 27, 36 par.1 dhe 2, 73 par.3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.212/22, datë 02.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,

në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.